



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCËVE

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT TË
BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK
DREJTORIA E HARMONIZIMIT PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM**

NJOFTIM

**PËR PROCESIN E REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR AUDITUES TË
BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK, SEZONI 2017-2018.**

Në mbështetje të Urdhërit të Ministrit të Financave Nr.34, datë 14.04.2017, Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (DHAB) njofton se, të gjithë kandidatët që janë shpallur fitues në listën përfundimtare për të ndjekur procesin e çertifikimit në sezonin 2017-2018, detyrohen të paguajnë tarifën e regjistrimit të përcaktuar në VKM-në Nr.116, datë 17.2.2016 “Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e Komisionit të Kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit”, kreu IV, pika 1, gërma (a).

Tarifa derdhet në llogarinë e Ministrisë së Financave “Të ardhura” në çdo degë banke të nivelit të dytë dhe është e pakthyeshme. Afati i pagesës së tarifës së regjistrimit është nga **data 12.06.2017** deri në **datën 03.07.2017**.

Të gjithë kandidatët e shpallur fitues në listën e publikuar, duhet të depozitojnë pranë DHAB-së, një kopje të mandatit të pagesës, jo më vonë se data **03.07.2017**.

Faturën për arkëtim të tarifës së regjistrimit e gjeni dhe shkarkoni lehtësisht nga faqja e internetit e Ministrisë së Financave me adresë: www.financa.gov.al.

Në rast se kandidati nuk kryen pagesën e tarifës së regjistrimit, atëherë menjëherë ç’regjistrohet nga procesi i certifikimit.

Për informacione të mëtejshme mund të vizitoni faqen e internetit e Ministrisë së Financave me adresë: www.financa.gov.al si dhe mund të kontaktoni me stafin e DHAB-së në adresën Bedri.Lila@financa.gov.al